

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-040
Prishtinë, më 18 nëntor 2008, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 18
NËNTOR 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci dhe Xhezair Murati, ndërsa munguan, me arsye, Xhavit Haliti, Naim Maloku dhe Slllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli dhe Mufera Sinik, ndërsa munguan Ibrahim Makolli, Ardian Gjini dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skender Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi; dhe

Nga OSBE: Lelja Selimi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës dhe me pikat shtesë, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe gjashtë pika shtesë.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 nëntor 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave, dhe të
4. Të ndryshme.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, kërkoi sqarime pse nuk është radhitur në rend dite edhe kërkesa e këtij grupi për ta ftuar në Interpelancë ministrinë e Shëndetësisë, z. Alush Gashi.

Drejtori i Departamentit për çështje ligjore dhe procedurale, Daut Beqiri, shpjegoi procedurat lidhur me radhitjen e Interpelancës në rend dite të seancës plenare të radhës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDD-së për ta ftuar në Interpelancë ministrinë e Shëndetësisë, z. Alush Gashi, radhitet si pikë e parë e rendit të ditës të seancës plenare më 27 nëntor 2008.
2. Të njoftohet Qeveria, përkatësisht ministri i Shëndetësisë, Alush Gashi, që të përgatit përgjigjen dhe të prezantojë në seance plenare, më 27 nëntor 2008.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 nëntor 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 11 nëntor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën plenare të radhës.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më **27 nëntor 2008**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për pyetje parlamentare,
2. Interpelanca e ministrit Alush Gashi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së,
3. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
4. Rishqyrtimi i Ligjit për tubimet publike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimi e Ligjit për Administratën tatimore dhe procedurat, dhe
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mandate dhe Imunitete për heqjen e statusit të deputetit z. Sabit Rrahmanit.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Projekt-Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovës prej vitit 1945 deri më 1999

Kryesia, pasi shqyrtoi tekstin e Projekt-Rezolutës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Të rishikohet teksti i Projekt-Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovës prej vitit 1945 deri më 1999, nëse i njëjti mund të ketë implikime buxhetore.

3.2 Shqyrtimi i kërkesave të deputetëve për të debatuar në Kuvend lidhur me gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Debati për gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të zhvillohet në seancën e ardhshme në pikën që ka të bëjë me emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale.

2. Të riazhurnohet Informata nga Qeveria e Kosovës lidhur me gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

3.3 Shqyrtimi i procedimit të mëtejshëm për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

Kryesia, pasi shqyrtoi çështjen e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohen Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që të formojnë Panelin rekrutues për të intervistuar kandidatët për Avokat të Popullit, në pajtim me Rregullat procedurale për zgjedhjen e Avokatit të Popullit.
2. Paneli rekrutues shtatanëtarësh përbëhet prej tre (3) anëtarëve nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe prej katër (4) anëtarëve nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, nga radhët e grupeve parlamentare të përfaqësuara në këto komisione.
3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi është Komision përgjegjës dhe raportues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit .
4. Punën e Komisionit dhe të Panelit rekrutues e mbështet zyrtari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe zyrtari i Shërbimit të Personelit.

3.4 Njoftimi me rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me procesin e shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Kryesia, pasi u njoftua me rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me procesin e shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës, vendosi që Rekomandimi t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendi.

4. Pikat shtesë

4.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë.

Kryesia, pasi shqyrtoi procedimin e këtij projektligji, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Udhëzohet propozuesi i Projektligjit për të drejtat e ish-të burgosurve politikë që nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Ekonomisë dhe e financave të sigurojë Deklaratën financiare për implikimet buxhetore të këtij projektligji.

4.2 Shqyrtimi i kërkesës së kryetarëve të grupeve parlamentare për kompensimin e shpenzimeve të deputetit Ramë Buja, kryetar i GP të PDK-së,

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendoi që deputetit Ramë Buja, kryetar i GP të PDK-së, t'ia kompensojë shërimin mjekësor jashtë vendit, sipas kërkesës së parashtruar.

4.3 Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesat për lejimin udhëtimeve jashtë vendit, vendosi si vijon: deputetit Sadik Idriz dhe të gjithë deputetëve të tjerë, që kanë qenë për vizitë zyrtare në Shqipëri prej 3-5 nëntor 2008, t'ua kompensojë mëditjet shtesë; deputetit Ibrahim Selmanaj i kompensohen mëditjet shtesë për pjesëmarrje në seminar në Ohër, Maqedoni, prej 5 deri më 8 nëntor 2008; si dhe deputetes Myzejene Selmani t'i bëhet pagesa paraprake për pjesëmarrjen në seminar në Londër, Angli.

4.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për sqarime lidhur me konkursin për tre anëtarë të Këshillit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit vlerësoi se konkursi i shpallur më 22 korrik 2008 edhe për tre anëtarë shtesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës është bërë me kërkesë të këtij Këshilli, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara dhe të miratuara sipas vendimit të mëparshëm për një anëtar të këtij organi, si dhe të vendimit të seancës plenare për krijimin e Komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidateve për anëtarë të Këshillit, datë 18 shtator 2008.

5. Të ndryshme

Xhezair Murati ngrehu çështjen e udhëtimeve jashtë vendit të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit dhe shprehu pakënaqësinë e tij se me rastin e udhëtimeve jashtë vendit vetëm një anëtar i Kryesisë nga radhët e komuniteteve joshqiptare po udhëton.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 14:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale